



Prishtinë: 02.09.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1392\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2184\_05\_21** i dt. 28.05.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 07.07.2021;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit V.T nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2184\_05\_21, i datës 28.05.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 28.05.2021 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2184\_05\_21 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit V.T nga Komuna e Prishtinës lidhur me kontestimin e faturave për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik nr.35034040.

I pakënaqur me vendimin e DMK-së, konsumatori V.T, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- I licencuari KEDS i ka instaluar njehsor me defekt – jo cilësor “Kohler” prej datës 02.06.2014 deri me 10.06.2015;
- Orëmatësi me defekt i ka shkaktuar rritje të shpenzimit prej 284.6 EUR në 483 EUR dhe në asnjë periudhë tjetër nuk është aq e shtrenjtë sa periudha kontestuese;
- Konsumatori kërkon që të krahasohen vitet dhe të shikohen shpenzimet reale që janë bërë dhe të kompensohet dëmi.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i ZRRë-së ka administruar provat si në vijim: Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit nr. 0160895 i dt.10.06.2015, Protokollin e shqyrtimit të njehsorit me nr.org.02, nr.11274 i dt.16.08.2018, ankesën e konsumatorit në KESCO të dt.30.01.2018, Përgjigjen e KESCO-s të dt.20.07.2018, Ankesën e konsumatorit në DMK të dt.27.02.2019, Vendimin e kontestuar dhe ankesën e konsumatorit të dt. 07.07.2021, Rrjedhën e energjisë elektrike dhe listat e leximit. Pas administrimit të të gjitha këtyre provave veç e veç, Bordi ka konstatuar këtë gjendje faktike:

- Bordi ka analizuar listat e leximit e në veçanti për periudhën 05/2014 deri më 05/2015 dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bërë inspektim dhe lexime të rregullta mujore dhe se në asnjë periudhë nuk ka evidentuar që nuk ka qasje në leximin e njehsorit elektrik apo që dyshon se njehsori nuk bënë matje të saktë. Po ashtu bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike. Krahasimi i shpenzimeve për periudhën kontestuese me periudhat e më vonshme me tre njehsorë elektrik, njehsorin kontestues nr.35034040, njehsorin nr.64099664 dhe njehsorin e tanishëm nr.44169560 vërteton se konsumatori ka luhatur të shpenzimeve të energjisë elektrike, **por jo që njehsori elektrik nr.35034040 të bërë regjistrim të lartë të shpenzimit të energjisë elektrike** apo që njehsori nuk ka regjistruar saktë shpenzimin e energjisë elektrike. Për këtë qëllim Bordi ka shqyrtuar shpenzimet e konsumatorit si mw poshtw:
  - i. me njehsorin kontestues: **nr.35034040** për periudhën 05/2014 deri në periudhën 05/2015, ku mesatarja e shpenzimeve mujore është **519 kWh/muaj**;
  - ii. me njehsorin elektrike **nr.64099664** mesatarja e shpenzimeve mujore për periudhat **05/2016** deri më **05/2017** është **446 kWh/muaj**, periudha **05/2017** deri me **05/2018** është **472 kWh/muaj**;
  - iii. kurse me njehsorin e tanishëm mesatarja e shpenzimeve mujore **nr.44169560** periudha **05/2019** deri me **05/2020** është **567 kWh/muaj**, si dhe periudha 05/2020 deri me 05/2021 është **513 kWh/muaj**.
- Nga analiza e bërë shpenzimit të energjisë elektrike të periudhës kontestuese me njehsorin kontestues nr.35034040, me njehsorët tjerë nr.64099664 dhe nr.44169560 për periudhat e njëjta **nuk vërehet se ka rritje të shpenzimit të energjisë elektrike** me njehsorin nr.35034040.
- Po ashtu, nga analizimi i protokollit të shqyrtimit të njehsorit elektrik njehsori elektrik bllobat i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik nuk ka dëmtime, sistemet matëse janë në rregull si dhe gabimi në matje është **-0.28%**. Bordi thekson se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar të gabimit të përcaktuar në Kodin e matjes së OSSH-së e i cili është **±2.5%**.

Andaj, nga sa u tha më sipër, Bordi i ZRRë-së ka vërtetuar se nuk ka rritje të shpenzimit të energjisë elektrike dhe se nga raporti i Qendrës së Kalibrimit rezulton se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar të matjes. Po ashtu, konsumatori nuk ka ofruar asnjë provë tjetër se njehsori elektrik kontestues ka regjistruar energji elektrike më shumë se sa njehsorët tjerë që i ka pasur në funksion.

Bordi i ZRRë-së bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KEDS/KESCO kanë respektuar nenin 28 par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të*



*dakorduar me konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar të zbatohet për cdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja dhe për konsumatorët e kualifikuar (me cmime të parregulluara), ashtu sic është rënë dakord në kontratën për furnizim”.*

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit V.T dhe
- Arkivit të ZRRE-së.